

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Llogaritë e mbyllura në Instagram, Rama mohon përfshirjen; EDP kërkon transparencë - Citizens.al
ADRESA	https://citizens.al/2026/09/04/llogarite-e-mbyllura-ne-instagram-rama-mohon-perfshirjen-edp-kerkon-transparence/
BURIMI	citizens-channel.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 21:43:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	4 shtator 2026, 15:43:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f8ebe2fd25e2dbd6bf41c1cb77d7ca05aba7a988e2728b3256c25d5f0618a0ee
TEKSTI	d9cd696e3f7dc35a9bcb175204131592ae606b6d3a3f408c2209e28bf4a460ea
PAMJA	b4352969e48ed0489dec6f029aca08af135cf152dabf3fcbe52b78954eb3ed7d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f208be8f78bdfbbee9d6d2d67c28f376e837a6b86c70b1ca5e326f0788912845
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	00a00f473eee6089e629c3fbe5b781cecb40006581d22ebdfab6238166e5deac
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmPnNf1qdmUZ7ZGmyYMWfEMaR1a5zbCFQKNxYmATJxZLPp



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f208be8f78bdfbbee9d6d2d67c28f376e837a6b86c70b1ca5e326f0788912845>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Llogaritë e mbyllura në Instagram, Rama mohon përfshirjen; EDP kërkon transparencë



Autor: Erisa Kryeziu

September 4, 2026



Mbyllja dhe kufizimi i dhjetëra llogarive në rrjetet sociale të aktivistëve, qytetarëve të angazhuar në protestat e Revolucionit Flamingo dhe përfaqësuesve të opozitës solli një përplasje mes kryeministrit Edi Rama dhe Partisë Demokratike Evropiane (EDP).

Të dyja palët shkëmbyen përgjigje ndaj njëri-tjetrit në rrjetin social X, pasi Demokratët Evropianë reagues ndaj raportimeve për mbylljen dhe kufizimin e llogarive në Instagram.

"Liria e shprehjes dhe kundërshtimi politik janë të drejta themelore demokratike. Një vend që po përparon drejt anëtarësimit në BE duhet të mbrojë çdo zë kritik që shprehet në mënyrë paqësore", shkroi EDP.

Reagimi i kryeministrit Rama ishte i drejtpërdrejtë. Ai e akuzoi EDP-në për "propagandë të ulët" dhe mohoi çdo përfshirje të qeverisë në mbylljen apo kufizimin e llogarive.

"Ne nuk kemi absolutisht asnjë lidhje me çaktivizimin apo kufizimin e ndonjë llogarie në rrjetet sociale dhe as nuk zotërojmë kapacitetin teknik për të kryer një operacion të tillë", shkroi Rama.

Kryeministri shkoi më tej, duke iu referuar "burimeve dashakeqe", të cilat, sipas tij, synojnë t'i japin jetë një proteste që "tashmë ka humbur vulltin".

"Po sikur e gjithë kjo manovër të vijë nga të njëjtat burime dashakeqe që ushqyen të ashtuquajturin 'Revolucioni Flamingo', shumë prej të cilave ushqyen edhe kaosin në Ceuta?", shkroi Rama.

Demokratët Evropianë iu përgjigjën Ramës duke theksuar se nuk e kishin akuzuar qeverinë shqiptare se qëndronte pas mbylljes së llogarive, qëndrim i përsëritur edhe në një përgjigje të dërguar sot për Citizens.al.

"Mohimi kategorik i kryeministrit Rama është sigurisht i mirëpritur. Por ai nuk i përgjigjet pyetjes themelore: pse kaq shumë llogari që u përkisnin figurave të opozitës, aktivistëve dhe qytetarëve të përfshirë në të njëjtën lëvizje protestuese u kufizuan ose u çaktivizuan pothuajse në të njëjtën kohë?", tha EDP-ja për Citizens.al.

Sekretari i Përgjithshëm i EDP-së, Sandro Gozi, tha se kërkesa e tyre ishte për transparencë dhe jo një akuzë ndaj qeverisë.

"Fyerjet nuk u përgjigjen pyetjeve. Ne nuk kemi pretenduar asnjëherë se qeveria shqiptare ishte përgjegjëse. Ajo që kërkuam ishte shumë e thjeshtë: transparencë nga Meta dhe vëmendje nga Komisioni Evropian", tha Gozi.

Ai shtoi se, nëse ekziston një shpjegim teknik për mbylljen e llogarive, Meta duhet ta bëjë atë publik.

"Nëse ekziston një shpjegim teknik plotësisht legjitim, Meta duhet ta japë atë. Nëse ka pasur abuzim të koordinuar me sistemin e raportimit, edhe këtë duhet ta dimë. Transparenca është në interes të të gjithëve, përfshirë edhe qeverinë shqiptare", tha Gozi.

Të Fundit




14 protestuesit lirohen pa masë sigurie, arrestimi shpallet i paligjshëm

4 September 2026 0



Llogaritë e mbyllura në Instagram, Rama mohon përfshirjen; EDP kërkon...

4 September 2026 0



Zërat e 'Revolucionit Flamingo' në Instagram sulmohen në të njëjtën...

3 September 2026 0



"Pasqyrë Albania": një premtim, pesë emra, 13 vjet

3 September 2026 0



Kulla te 'Zyber Hallulli': gjykata urdhëron hetim, KISH firmos kontratën tr...

3 September 2026 0



Aleança për
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

EDP tha gjithashtu se i ka kërkuar Meta-s transparencë dhe Komisionit Evropian që ta shqyrtojë rastin. Deri të premtën, më 4 shtator, sipas EDP-së, Meta nuk i kishte kthyer përgjigje kërkesës së saj.

Për EDP-në, kjo është arsyeja pse çështja kërkon transparencë dhe jo akuza.

"Për ne, kjo mbetet një çështje legjitime e lirisë së shprehjes, pluralizmit politik dhe transparencës në mënyrën se si platformat e mëdha digjitale zbatojnë sistemet e tyre të moderimit", thuhet në përgjigjen e EDP-së për Citizens.al.

Meta ka pranuar se disa prej llogarive të prekura janë hequr gabimisht. Në një përgjigje për BIRN, kompania tha se po rishikon masat e marra ndaj llogarive dhe se disa prej tyre tashmë janë rikthyer. Meta kërkoj gjithashtu ndjesë për shqetësimin e shkaktuar.

Kompania, megjithatë, nuk ka dhënë deri tani një shpjegim të plotë për arsyet që çuan në mbylljen e llogarive apo nëse raportimet e shumta ndaj tyre kanë qenë të koordinuara.

Në orët e para të mëngjesit të 2 shtatorit, dhjetëra llogari në Instagram u kufizuan ose u mbyllën pothuajse njëherazi. Aktivistët e prekur thanë për Citizens.al se humbën aksesin në llogaritë e tyre pa paralajmërim, rreth orës 01:00, ndërsa qytetarë dhe aktivistë të tjerë ishin ndeshur me situata të ngjashme edhe ditë më parë.

Rastet janë ndjekur edhe nga "Repro Uncensored", organizatë ndërkombëtare që dokumenton censurën digjitale dhe mbështet përdoruesit në rikthimin e llogarive. Sipas themelueses dhe drejtoreshës ekzekutive të saj, Martha Dimitratou, organizata ka dokumentuar dhjetëra raste censurimi të llogarive shqiptare të lidhura me "Revolucionin Flamingo" vetëm gjatë ditëve të fundit.

Ajo thotë se në rastet e trajtuara nga organizata janë konstatuar edhe kufizime të shtrirjes së përmbajtjeve, bllokime të funksioneve të bashkëpunimit dhe çaktivizime të plota të llogarive. Shumica e rasteve, sipas saj, kanë ndodhur në platformat e Meta-s dhe në TikTok.

"Repro Uncensored" thotë se nuk ka gjetur prova që përmbajtjet e protestës të kenë shkelur realisht të drejtat e autorit apo rregullat e platformave. Në disa raste, sipas organizatës, pas ndërhyrjes së saj, Meta ka pranuar se heqjet ishin bërë gabimisht.

Lexo gjithashtu:

- [Zërat e 'Revolucionit Flamingo' në Instagram sulmohen në të njëjtën orë](#)

Erisa Kryeziu

Erisa Kryeziu ka përfunduar studimet e larta në Gazetari dhe Komunikim dhe Master Shkencor në Marrëdhënie me Publikun në Universitetin e Tiranës. Prej pesë vitesh është gazetare dhe menaxhere e projekteve pranë Citizens.al, ku raporton për çështje sociale dhe të drejtat e njeriut, veçanërisht për çështjet e të drejtave në punë, në arsim, barazinë gjinore, grupet e marginalizuara, personat me aftësi të kufizuara si dhe për çështje mjedisore.

Njëkohësisht punon edhe si koordinatorë projektesh me fokus rininë dhe edukimin mediatic. Përdoruese e teknikave të reja të raportimit sikurse "Mobile Journalism" dhe e mjeteve të angazhimit qytetar në raportim (ECR-Engage Citizens Journalism).



< PRAPA

Zërat e 'Revolucionit Flamingo' në Instagram sulmohen në të njëjtën orë... 14 protestuesit lirohen pa masë sigurie, arrestimi shpallet i paligj...

PARA >

Leave a Reply

Your email address will not be published. Required fields are marked *

Comment *


Name *

Email *

Website

Post Comment

Te ngjajshme



14 protestuesit lirohen pa masë sigurie, arrestimi shpallet i paligjshëm

📅 4 September 2026 💬 0

Mëngjesin e 4 shtatorit, në ditën e 97-të të protestave të përditshme, dhjetëra qytetarë u mbledhën para Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pritje të ...



Citizens Channel është një media që ka për qëllim të promovojë zhvillimin e gazetarisë qytetare në Shqipëri dhe të fuqizojë zëra të përgjegjshëm, në përputhje me vlerat e një shoqërie gjithë pranuese dhe tolerante, në respektim të lirive e të drejtave themelore të njeriut.

Kontakt

Rreth Citizens | Kushtet e Përdorimit | Politika e Privatësisë | Kontakt

© 2026 Citizens Channel | Të gjitha të drejtat e rezervuara,

Zhvilluar nga **SMS**